

V E N D I M
Nr.499, datë 8.11.1999

**PËR MBULIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE, QË RRJEDHIN NGA ZBATIMI I
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.265, DATË 3.6.1999**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 “Për buxhetin e shtetit për vitin 1999” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.265, datë 3.6.1999 “Për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore”, me propozimin e zëvendëskryeminstres dhe Ministre e Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1.Akademisë së Shkencave, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohen 4 200 000 lekë (katër milionë e dyqind mijë), për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.265, datë 3.6.1999.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohen Akademia e Shkencave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta